

VENDIM
Nr. 874, datë 19.12.2012

**PËR DHËNIE ASISTENCE EKONOMIKE TË MENJËHERSHME, PERSONAVE
QË PËRFITOJNË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 66 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie asistence ekonomike të menjëhershme, në shumën 2 000 lekë (dy mijë) lekë, të patatueshme, për grupet e mëposhtme:

a) Personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Personat, që marrin pension, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c) Veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, personat, që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe personat, që marrin pension të posaçëm shtetëror, kur nuk përfitojnë, sipas përcaktimit në shkronjat “a” e “b” të këtij vendimi.

ç) Personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, si dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar.

d) Personat, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

dh) Personat e përcaktuar në shkronjat “a” “b” “c” “ç” dhe “d” të këtij vendimi, që nuk u është caktuar përfitimi, por me kusht që datën e fillimit të pensionit e kanë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 170 000 000 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe mbarten në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore edhe në vitin e ardhshëm, në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2012.

3. Fondi prej 1 170 000 000 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh përdoret, përkatësisht:

a) 1 157 400 000 (një miliard e njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind mijë) lekë, për asistencën e menjëhershme të pensionistëve;

b) 12 600 000 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për mbulimin e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe për shpenzimet e administrimit të tyre.

4. Procedura e pagesës dhe administrimit të asistencës së menjëhershme për pensionistët realizohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha